



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2714/5 Prot.

Tiranë, më 09.12.2025

VENDIM

Nr. 368, Datë 02.12.2025

**“PËR MIRATIMIN E OPINIONIT PËR KANDIDATEN FATJONA MEMÇAJ QË
KA APLIKUAR NË PROCEDURËN E KOMANDIMIT SI PROKUROR
NDËRLIDHËS PRANË EUROJUST”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.12.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për miratimin e opinionit për kandidaten Fatjona Memçaj që ka aplikuar në
procedurën e komandimit si prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2714/4 prot., datë 21.11.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin, z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

S. Plenore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2714/5 Prot.

Tiranë, më 09.12.2025

VENDIM

Nr. 368, Datë 02.12.2025

**“PËR MIRATIMIN E OPINIONIT PËR KANDIDATEN FATJONA MEMÇAJ QË
KA APLIKUAR NË PROCEDURËN E KOMANDIMIT SI PROKUROR
NDËRLIDHËS PRANË EUROJUST”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.12.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për miratimin e opinionit për kandidaten Fatjona Memçaj që ka aplikuar në
procedurën e komandimit si prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2714/4 prot., datë 21.11.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin, z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Me Vendimin nr. 127, datë 07.06.2023, “Për komandimin e magjistratit”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim, Këshilli)* ka miratuar komandimin e një magjistrati në pozicionin e Prokurorit ndërlidhës pranë Eurojust. Periudha e komandimit sipas këtij vendimi është 2.6 vjet (dy vjet e gjashtë muaj) duke filluar nga data 01.07.2023, afat i cili plotësohet në datën 01.01.2026.
2. Me Shkresën nr. 1320/1 prot., datë 22.10.2025, “Mbi komandimin e prokurorit ndërlidhës në Eurojust”, të Prokurorit të Përgjithshëm (regjistruar me nr. 2355/1 prot., datë 22.10.2025) drejtuar Këshillit është kërkuar nisja e procedurës së komandimit të një Prokurori ndërlidhës pranë Eurojust për një periudhë 5 (pesë) vjetësh, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 5, të “Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust”, ratifikuar me Ligjin nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust -it”.
3. Prokurori ndërlidhës i Eurojust-it është magjistrati prokuror i caktuar në bazë të legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë. Mandati dhe kohëzgjatja e emërimit përcaktohet nga Republika e Shqipërisë.
4. Instituti ligjor i komandimit dhe procedurat e komandimit të prokurorëve rregullohen në nenet 53 dhe 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar *(në vijim, Ligji për Statusin)*.
5. Në bazë të nenit 54, pika 3, të Ligjit për Statusin, Këshilli pranon kandidaturat e magjistratëve që përmbushin kriteret specifike të pozicionit ku kërkohet komandimi, pas shpalljes publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Shpallja duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, dhe domosdoshmërisht:
 - a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes;
 - b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
 - c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.
6. Sipas nenit 54, pika 4, të Ligjit për Statusin brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, Këshilli përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi është në përputhje me interesat e lartë të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
7. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës.
8. Institucioni ku kryhet komandimi i magjistratëve vlerëson aplikimet dhe kërkon komandimin e magjistratit të përzgjedhur për një periudhë të caktuar kohe.

9. Këshilli merr vendim për komandimin e magjistratit brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, sipas përcaktimeve të nenit 54, pika 5, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohen kushtet e komandimit.

10. Me Vendimin nr. 341, datë 03.11.2025, *“Për plotësimin e 1 (një) pozicioni si Prokuror Ndërlidhës pranë Eurojust, përmes procedurës së komandimit”*, Këshilli vendosi shpalljen e garës dhe, me Njoftimin e datës 03.11.2025, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit janë publikuar kriteret ligjore, dokumentacioni dhe afati i aplikimit për prokurorët e interesuar.

Në përfundim të afatit, rezultoi si aplikim i vetëm kërkesa e paraqitur nga prokurorja Fatjona Memçaj.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mori në shqyrtim kërkesën e kandidates në fjalë dhe përgatiti Opinionin, si më poshtë:

“Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 pika 2 dhe 54 të Ligjit për Statusin, si dhe Ligjit nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust”, me Vendimin nr. 341, datë 03.11.2025 ka shpallur garën për të shprehur interesin për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, si Prokuror Ndërlidhës pranë Eurojust, nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së Njoftimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim pranë Këshillit ka paraqitur kërkesë një prokuror.

Në datë 11.11.2025, magjistratja Fatjona Memçaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm i është adresuar Këshillit me shprehjen e interesit për komandim pranë Eurojust.

Me Vendimin nr. 127, datë 07.06.2023, “Për komandimin e magjistrates Fatjona Memçaj si prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”, prokurorja Memçaj është komanduar në pozicionin e Prokurorit ndërlidhës, me periudhë komandimi 2.5 vjet (dy vjet e gjashtë muaj) duke filluar nga data 01.07.2023.

Në zbatim të nenit 54, pika 4 të Ligjit për Statusin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projektopinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese, si dhe duke vlerësuar cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokurorja Fatjona Memçaj ushtron funksionin e magjistratit që prej muajit tetor të vitit 2001, ku është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ku, dhe ka vazhduar detyrën deri në muajin shkurt të vitit 2008. Më pas ka pasur një eksperiencë drejtuese në institucionin e Presidentit të Republikës për t'u rikthyer në sistemin e prokurorisë, fillimisht në Prokurori të Përgjithshme si Drejtor Kabineti në muajin janar të vitit 2013, e më pas në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në muajin gusht të vitit 2013 (ku aktualisht ka emërimin e përhershëm).

Nga dosja personale rezulton se, prokurorja Fatjona Memçaj ka një eksperiencë profesionale në punë për afro 24 (njëzet e katër) vjet, nga të cilat rreth 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet si magjistrate në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjithashtu, prokurorja Fatjona Memçaj ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me Vendim të formës së prerë nr. 16, datë 03.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kandidatja nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Vlen të theksohet se, prokurorja Fatjona Memçaj është e komanduar në pozicionin e Prokurores Ndërlidhëse pranë Eurojust për një periudhë 2.5 vjet (dy vjet e gjashtë muaj), afati i të cilit përfundon më 01.01.2026.

Sipas pikës 6 të nenit 53 të Ligjit për Statusin përcaktohet se: “periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj” “Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij”. Referuar nenit 56 pika 1 dhe 3 të po këtij ligji, parashikohet se: “Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati. Përcaktimet e pikës 2, të këtij neni, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, për kërkesën respektive të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Në interpretim të këtyre parashikimeve, brenda afatit ligjor Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nisjen e procedurave për të shprehjen e interesit për t'u komanduar, si Prokuror Ndërlidhës pranë Eurojust, kandidatave që vijnë prej radhëve të prokurorëve, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Me përgatitjen e opinionit nga ana e Këshillit për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe duke qenë se kemi një kandidaturë të vetme, ky i fundit ka në diskrecionin e tij të vlerësojë nëse mund të

ripërsërisë kërkesën për komandim edhe për një periudhë tjetër 5 (pesë) vjeçare prokuroren Fatjona Memçaj.

Për sa i përket eksperiencave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë ajo ka eksperiencë në mbikëqyrjen e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe eksperiencën specifike në pozicionin e Prokurores Ndërlidhëse pranë Eurojust.

Për sa i përket njohjes së Gjuhës Angleze, kandidatja Fatjona Memçaj zotëron Çertifikatë IELTS nga British Council, si dhe ka kryer studime pasuniversitare në Universitete në Mbretërinë e Bashkuar.

Përveç sa më sipër, kandidatja Fatjona Memçaj ka një karrierë të gjatë akademike, si dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit si dhe është autore publikimesh.

Në këto kushte, për këtë prokurore nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, prokurorja Fatjona Memçaj, prej pesë vjetësh ushtron funksionin e Prokurorit Ndërlidhës pranë Eurojust, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se, komandimi i prokurores Fatjona Memçaj pranë Eurojust nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Më tej, vlen të theksojmë se, Presidenti i Eurojust, z. Schmid, institucioni ku, kandidatja ushtron aktualisht funksionin e Prokurorit ndërlidhës ka dërguar një Letër Rekomandimi (regjistruar me nr. 2714/2 prot., datë 12.11.2025), ku vlerëson me nota maksimale punën e znj. Fatjona Memçaj pranë këtij institucioni.”

12. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit, vijimin e procedurave të komandimit të një prokurori si Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, përmes miratimit të Opinioneve për kandidaten e vetme që ka shprehur interesin, znj. Fatjona Memçaj, me qëllim dërgimin e këtij opinioni pranë Prokurorit të Përgjithshëm, si institucioni përgjegjës i vlerësimit të kandidaturës i cili kërkon dhe komandimin e kandidatit të përzgjedhur për një periudhë të caktuar kohore, sipas nenit 54, pikat 4 dhe 5, të Ligjit për Statusin.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 53, pikat 1 dhe 2, dhe 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Ligjin nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së

Shqipërisë dhe Eurojust -it”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Opinionit për kandidaten Fatjona Memçaj që ka aplikuar në procedurën e komandimit si Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust.
2. Të njoftohet me këtë vendim dhe Opinionin e miratuar Prokurori i Përgjithshëm si dhe kandidatja Fatjona Memçaj.
3. Ky Opinion publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 02.12.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirëla Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

Tiranë, më 02.12.2025

Opinion për kandidaten Fatjona Memçaj që ka aplikuar në procedurën e komandimit si Prokuror ndërlidhës pranë Eurojust

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 pika 2 dhe 54 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (në vijim Ligji për Statusin), si dhe në nenin 5 të ligjit nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust”, në datën 24.04.2023 me vendimin nr. 341, ka hapur garën për të shprehur interesin për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, si Prokuror Ndërlidhës pranë Eurojust, nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim pranë Këshillit, ka paraqitur kërkesë një prokuror.

Në datë 11.11.2025, zonja Fatjona Memçaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i është adresuar Këshillit me shprehjen e interesit për komandim pranë Eurojust.

Me vendimin nr. 127, datë 07.06.2023, “Për komandimin e magjistrates Fatjona Memçaj si prokuror ndërlidhës pranë Eurojust”, prokurorja Memçaj është komanduar në pozicionin e Prokurorit Ndërlidhës, me periudhë komandimi 2.5 vjet (dy vjet e gjashtë muaj) duke filluar nga data 01.07.2023.

Në zbatim të nenit 54 pika 4 të Ligjit për Statusin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projektopinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese, si dhe duke vlerësuar cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

Prokurorja Fatjona Memçaj ushtron funksionin e magjistratit që prej muajit tetor të vitit 2001, ku është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ku, dhe ka vazhduar detyrën deri në muajin shkurt të vitit 2008. Më pas ka pasur një eksperiencë Drejtuese në Institucionin e Presidentit të Republikës për t'u rikthyer në sistemin e prokurorisë, fillimisht në Prokurori të Përgjithshme si Drejtor Kabineti në muajin janar të vitit 2013, e më pas në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në muajin gusht të vitit 2013 (ku aktualisht ka emërimin).

Nga dosja personale rezulton se prokurorja Fatjona Memçaj ka një eksperiencë profesionale në punë për afro 24 (njëzet e katër) vjet, nga të cilat rreth 19 (nëntëmbëdhjetë) vjet si magjistrate në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe atë të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjithashtu, zonja Memçaj ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë nr. 16, datë 03.05.2018.

Vlen të theksojmë se, zonja Memçaj është e komanduar në pozicionin e Prokurores Ndërlidhëse pranë Eurojust për një periudhë 2.5 vjet (dy vjet e gjashtë muaj), afati i të cilit përfundon më 01.01.2026.

Prokurorja Fatjona Memçaj nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sipas pikës 6 të nenit 53 të Ligjit për Statusin përcaktohet se: “periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj” “Magjistrati nuk mund të komandohet për më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij”. Referuar nenit 56 pika 1 dhe 3 të po këtij ligji, parashikohet se: “Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati. Përcaktimet e pikës 2, të këtij neni, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim, për kërkesën respektive të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Në interpretim të këtyre parashikimeve, brenda afatit ligjor Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nisjen e procedurave për të shprehjen e interesit për t'u komanduar, si Prokuror Ndërlidhës pranë Eurojust, kandidaturave që vijnë prej radhëve të prokurorëve, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Me përgatitjen e opinionit nga ana e Këshillit për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe duke qenë se kemi një kandidaturë të vetme, ky i fundit ka në diskrecionin e tij të vlerësojë nëse mund të ripërsërisë kërkesën për komandim edhe për një periudhë tjetër 5 (pesë) vjeçare prokuroren Fatjona Memçaj.

Për sa i përket eksperiencave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë ajo ka eksperiencë në mbikëqyrjen e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe eksperiencën specifike në pozicionin e Prokurores Ndërlidhëse pranë Eurojust.

Për sa i përket njohjes së Gjuhës Angleze, zonja Memçaj zotëron certifikatë IELTS nga

British Council, si dhe ka kryer studime pasuniversitare në Universitete të Mbretërisë së Bashkuar.

Përveç sa më sipër, zonja Fatjona Memçaj ka një karrierë të gjatë akademike, si dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit si dhe është autore publikimesh.

➤ Në këto kushte për këtë prokurore nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, zonja Memçaj, prej pesë vjetësh ushtron funksionin e Prokurorit Ndërlidhës në Eurojust, në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se, komandimi i zonjës Fatjona Memçaj pranë Eurojust nuk pasjellë cenim të interesave të larta të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Më tej, vlen të theksojmë se, zoti Michael Schmid, Presidenti i Eurojust, institucioni ku, zonja Memçaj ushtron aktualisht funksionin e prokurorit ndërlidhës ka dërguar një letër rekomandimi, e cila është administruar në institucion me nr. 2714/2 prot., datë 12.11.2025, ku vlerëson me nota maksimale punën e zonjës Memçaj pranë këtij institucioni.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vijimin e procedurave të komandimit të një prokurori si prokuror ndërlidhës pranë Eurojust për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me miratimin e opinionit për kandidaten e vetme që ka shprehur interesin, zonjën Fatjona Memçaj, me qëllim dërgimin e opinionit pranë Prokurorit të Përgjithshëm, si institucioni kompetent i vlerësimit të aplikimit të kryer.